



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		27 / 07 / 2023	
Nr. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
87-060/03	36499		

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit- Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përkatësisht nenit 9, pika 1.3, dhe Vendimit nr. 12-030-65513, të datës 23.12.2021 të Kuvendit Komunal, thirret mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS).

F T E S Ë

Për anëtarin/ën _____, nga _____
që të marrë pjesë në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS), lidhur me zhvillimet në Komunën e Drenasit. Mbledhja e rregullt do të mbahet më datën 03.08.2023, ditë e enjte, nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit Komunal në Drenas.

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBS-së të mbajtur me datë 18.05.2023.
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/06/KKSBS-Procesverbali.pdf>;
2. Raport lidhur me zjarret fushore dhe malore nga NJPZSH-ja;
3. Masat e sigurisë për Muajin e Mërgatës;
4. Aksidentet në trafik, raport nga Stacioni Policor në Drenas

Kopje: Anëtarëve të KKSBS-së



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
FETJAR		27/07/2023	
Org.	Redovni	Shtojca	Vlera
01	060/83-36491		

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KESHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)

IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 03.08.2023

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 4

Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒

Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

☐

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 15

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da ☐

Jo / Ne ☒

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da ☐

Jo / Ne ☒

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

KFOR LMTK9a dhe UNMIK si monitorues

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.05.2023. <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/06/KKSB-Procesverbali.pdf>;
2. Raport lidhur me zjarret fushore dhe malore nga NJPZSH-ja;
3. Masat e sigurisë për Muajin e Mërgatës;
4. Aksidentet në trafik, raport nga Stacioni Policor në Drenas

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e radhës me 3 Gusht në sallën e Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 15 anëtarë të KKSB-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit, drejtorë të drejtorive komunale dhe monitorues nga UNMIK dhe KFOR. Mbledhja u udhëheq nga nënkryetari i komunës, z. Arben Shala.

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan ishin:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.05.2023. <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/06/KKSB-Procesverbali.pdf>. Lidhur me këtë pikë anëtarët nuk patën ndonjë koment dhe u miratua në mënyrë unanime.
2. Raport lidhur me zjarret fushore dhe malore nga NJPZSH-ja; Lidhur me këtë pikë, shefi i Njësisë së Zjarrfikësve njoftoi se nga Janari e deri tani kanë intervenuar 116 raste të natyrave të ndryshme.

“Në krahasim më vitin e kaluar, periudhën e njëjtë nuk kemi zjarre fushore malore të paramasave të mëdha sikurse vitin e kaluar. Deri më tash, nga Janari kemi 116 raste të natyrave të ndryshme, 74 zjarre, alarme të rrejshme 2, 3 aksidente që kena marrë pjesë, intervenime teknike 13 raste, vërshime 23 raste, shërbime teknike 1 rast. Diçka më shqetësuese që vlen të theksohet thirrjet telefonike me KEDS, na për më siguru një shtëpi telefonojmë në KEDS, një numër telefoni fiks duhet që na me telefonu direkt dhe jo përmes linjës së nivelit qendror”, ka njoftuar të pranishmit.

3. Masat e sigurisë për Muajin e Mërgatës; Zyrтари i Drejtorisë së Inspekcionit z.Ardian Gashi ka njoftuar se si inspektorat çdo natë kanë mbikëqyrë nga dy zyrtarë në shesh gjatë muajit të mërgatës për të siguruar qoftë produktet që janë shitur, apo mënyrën e shfrytëzimit të sheshit të lejuar organizatorit të këtij eventit. Ai ka treguar se bashkë me zyrtarët policor kanë mbikëqyrë mbarëvajtjen e muajit të mërgatës sa i përket sigurisë së përgjithshme. Telashe apo incidente që kanë rrezikuar sigurinë e qytetarëve nuk ka pasur.

4. Aksidentet në trafik, raport nga Stacioni Policor në Drenas. Sa i përket sigurisë në trafik në mbledhje ishte i pranishëm komandanti i Stacionit Policor në Drenas, Driton Morina, i cili theksoi se çdo vit përgatisin plane operative ndryshme ku fokus është siguria në trafik. Ai njoftoi pjesëmarrësit se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, Janar-Gusht në Drenas kanë ndodhur 135 aksidente, 57 aksidente më shumë. Prej këtyre aksidenteve, 15 kanë qenë me lëndime, 120 me dëme materiale. Ndërsa, 4 aksidente më të cilat janë marrë njësia rajonale kanë qenë me fatalitet. Kurse, për tiketa për këtë periudhë janë shqiptuar 5292 gjoba ndaj kundërvajtëse.

5. Të ndryshme

Tek të ndryshmet diskutuan tema të ndryshme si pajisja me libra për fëmijët, sanimi i gropave nëpër rrugë rajonale që nuk po e bëjë ministria përkatëse dhe mundësinë që viteve tjera të subvencionohen organizata që kanë projekte që ndërlidhen më mbrojtjen e hapësirave publike. Kurse, komandanti z.Morina ngriti çështjen e sinjalizimit në dy parkingjet dhe rrugën ‘Ilaz Kodra’.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKS-së:
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)



Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Ramiz Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 01.09.2023

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKS-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKS-së.